

Vendim nr. 258 datë 08.11.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Sonila Bejtja,	Anëtare
Genti Ibrahimimi,	Anëtar

në datën 08.11.2024 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 12 (I) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ILIR MERKAJ

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 00-2022-893 (224), datë 02.06.2022 (rekursi); nr. 00-2024-1376, datë 04.04.2024 (rishikimi) të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 15, 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 71/a, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Genti Ibrahimimi, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Ilir Merkaj ka pasur në pronësi një ndërtesë njëkatëshe me sipërfaqe 115 m² truall dhe 115 ndërtesë, të regjistruar në Zyrën Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë, sipas certifikatës për vërtetimin e pronësisë me nr. 1074941, zona kadastrale 2074, nr. pasurie 1218/4, volumni 7, faqja 105, me adresë “Vlorë – Kaninë”.

2. Në datën 13.03.2014 në objektin e kërkuesit është ushtruar kontroll nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, sot Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), i cili ka mbajtur procesverbalin nr. 03, datë 13.03.2014 “Për konstatimin e kundërvajtjes administrative”, me arsyetimin: “*Objekti dykatësh me sipërfaqe ndërtimore 188 m², konstruktion B/A, i ndërtuar në Kaninë, kati i parë i përfunduar në funksion market, kati dytë përfunduar karabina, mure. I gjithë objekti dykatësh është pa leje përkatëse.*”.

3. Në vijim, IKMT-ja, me vendimin nr. 01, datë 13.03.2014 “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm”, ka vendosur: “*Dënimin e kundërvajtësit Ilir Merkaj me prishjen e objektit të kundërligjshëm objekt 2-katësh, sipërfaqe 188 m²*” dhe në datën 16.03.2014 është ekzekutuar vendimi për prishjen e tij. Në datën 18.03.2015 kërkuesi i është drejtuar gjykatës, duke pretenduar, se IKMT-ja ka vepruar në kundërshtim me ligjin.

4. Me vendimin nr. 830, datë 09.06.2015, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka vendosur pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë dhe detyrimin e IKMT-së të dëmshpërblejë kërkuesin për dëmin e shkaktuar si pasojë e prishjes së ndërtimit në vlerën 3.773.955 lekë. Rrëzimin për pjesën tjetër të padisë. Kjo Gjykatë ka arsyetuar se kërkuesi legjitimohet të kërkojë dëmshpërblimin vetëm për sipërfaqen e ndërtimit prej 115 m², e cila është e regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme Vlorë dhe për sa i përket kërkimit për dëmin e shkaktuar pasurisë edhe për katin e dytë të papërfunduar, gjykata çmon se paditësi nuk legjitimohet, pasi nuk ka provuar se e disponon këtë pjesë me titull pronësie të ligjshme.

5. Me vendimin nr. 4304, datë 26.11.2018, Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë. Pranimin e pjesëshëm të padisë dhe detyrimin e IKMT-së t’i shpërblejë kërkuesit dëmin e shkaktuar si pasojë e prishjes së ndërtimit prej 115 m² lokal shërbimi, të regjistruar në pronësi të tij, dhe 188 m² ndërtim të papërfunduar në proces legalizimi, në vlerën 11.208.186. Kjo gjykatë ka arsyetuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë në interpretim e zbatim të gabuar të ligjit material, për rrjedhojë ankimi i kërkuesit duhet të pranohet dhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë të ndryshohet. Kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit kanë ushtruar rekurs, më 21.01.2019, kërkuesi, IKMT-ja dhe Avokatura e Shtetit, duke kërkuar prishjen dhe kthimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit, me tjetër trup gjykues.

6. Pas rekursit të ushtruar nga palët, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2022-893 (224), datë 02.06.2022, ka vendosur prishje e vendimit nr. 4304, datë 26.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 830, datë 09.06.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, duke arsyetuar se, me të

drejtë, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Vlorë ka arritur në konkluzionin se kërkuesi ka pasur në pronësi një ndërtesë njëkatëshe me sipërfaqe 115 m² truall dhe 115 ndërtesë, sipas certifikatës për vërtetimin e pronësisë. Rezulton se gjendja faktike e sipërfaqes së ndërtimit është 188 m², pra 73 m² më tepër se ajo e regjistruar në regjistrat publikë, për të cilën pala paditëse ka aplikuar për leje legalizimi. Nga ana tjetër, ashtu sikurse ka arritur në përfundim gjykata e shkallës së parë, pala e paditur, IKMT-ja, ka vepruar në kapërcim të kompetencave të dhëna nga ligji, pasi ka prishur edhe ndërtesën prej 115 m², për të cilën pala paditëse disponon të gjithë dokumentacionin ligjor.

7. Në datën 04.08.2023 kërkuesi ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për rishikimin e vendimit nr. 830, datë 09.06.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

8. Me vendimin nr. 00-2024-1376, datë 04.04.2024, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e kërkesës së kërkuesit për rishikimin e vendimit të gjykatës së apelit, me arsyetimin se kërkesa nuk përmbante asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 494 të Kodit të Procedurës Civile.

9. Kërkuesi në datën 05.08.2024 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit, e cila, pas plotësimit të dokumenteve, është regjistruar në datën 19.09.2024.

II

Pretendimet e kërkuesit

10. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se IKMT-ja i ka cenuar të drejtën për proces të rregullt ligjor, të garantuar në nenin 42 të Kushtetutës, pasi i ka hequr atij përfundimisht të drejtën e posedimit dhe gëzimit të sendit duke e bërë këtë në mënyrë të kundërligjshme dhe me keqbesim dhe pa pasur në misionin e tij ushtrimin e shpronësimit për interes publik. Keqbesimi i IKMT-së qëndron në faktin se në të njëjtën datë kur është mbajtur akti i konstatimit, pa i dhënë asnjë mundësi kërkuesit të parashtronte pretendimet e tij dhe të paraqiste prova, ka nxjerrë vendimin për prishjen e objektit, duke e ekzekutuar atë 3 ditë më pas.

10.1. *E drejta e pronës*, pasi prona e kërkuesit është prishur në kundërshtim flagrant dhe jo për interesa publikë, për rrjedhojë nuk duhet të dëmshpërblehet me vlerën e shpronësimit, por me vlerën reale të tregut.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimimin e kërkesit

11. Çështja e legjitimitit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuarra në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Këto kritere paraprake të pranueshmërisë së kërkesës janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

12. Kolegji vëren se kërkuesi ka parashtruar pretendimet për procesin e themelit të përfunduar me vendimin nr. (00-2022-893), 224, datë 02.06.2022 të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë për shkak të cenimit të së drejtës së pronës nga IKMT-ja, pasi prona është prishur në kundërshtim me ligjin dhe se ai duhet të dëmshpërblehet sipas vlerës reale të tregut.

13. Në këndvështrim të verifikimit të plotësimit të këtyre kriterëve, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

14. Për sa i takon *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata në praktikën e saj ka pranuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, individi mund t’i drejtohet asaj për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive. Kjo nënkupton që ankuesi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuesi, i cili përpara se t’i drejtohet Gjykatës duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet ligjore të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Në rastin konkret, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit në Gjykatën e Lartë, për rrjedhojë ai nuk ka mjete të tjera në dispozicion përveç ankimit kushtetues individual.

16. Lidhur me legjitimimin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000 ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Gjykata në jurisprudencën e saj, në rastet e kundërshtimit të vendimeve gjyqësore, ka llogaritur afatin ligjor 4-mujor, duke filluar nga data e dhënies së vendimit nga gjykata, që ka përfunduar procesin gjyqësor, nëse kërkuesi nuk provon në nivel kushtetues se ka marrë dënim në një datë të ndryshme (*shih vendimet nr. 14, datë 21.06.2022; nr. 12, datë 24.05.2022 të Gjykatës Kushtetuese*).

17. Kolegji vëren se vendimi i Gjykatës së Lartë, që ka përbyllur procesin gjyqësor për shqyrtimin e themelit të çështjes është i datës 02.06.2022, ndërsa kërkuesi i është drejtuar Gjykatës në datën 05.08.2024, pasi Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1376, datë 04.04.2024, ka vendosur mospranimin e kërkesës për çështjen me objekt rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë nr. 830, datë 09.06.2015 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

18. Në vlerësimin e Kolegjit, paraqitja e një kërkesë për rishikim, që nuk pranohet nga gjykata, nuk përcakton ditën se kur vendimi gjyqësor i kundërshtuar është bërë përfundimtar, me qëllim përlllogaritjen e afatit ligjor 4–mujor të paraqitjes së ankimit kushtetues individual. Në nxjerrjen e këtij përfundimi, Kolegji mban në konsideratë faktin se kërkesa për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si një mjet i jashtëzakonshëm ankimi, kur nuk pranohet nga gjykata, nuk prek zgjidhjen përfundimtare të një procesi gjyqësor.

19. Për më tepër, Kolegji vlerëson se në paraqitjen e ankimit kushtetues individual, me objekt kundërshtimin e procesit të rishikimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, individët nuk mund të pretendojnë të parashtrojnë pretendime që lidhen me procesin gjyqësor për themelin e çështjes, duke përdorur afatin ligjor 4-mujor të procesit të rishikimit të vendimit gjyqësor si mjet të jashtëzakonshëm të ankimit, i cili është refuzuar nga gjykata si i pabazuar në ligj.

20. Për sa më lart, në lidhje me kërkimin thelbësor të parashtruar nga kërkuesi, si në objektin e kërkesës, ashtu edhe në përmbajtjen e saj, për shqyrtimin e themelit të çështjes dhe jo për procesin e rishikimit, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual është paraqitur jashtë afatit ligjor 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

21. Në kushtet kur kriteri paraprak për legjitimimin *ratione temporis* nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterit *ratione materiae* bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre. Prandaj, në përfundim, Kolegji çmon se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.